



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 15.10.2018

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
PROTOKOLLIN 2005 TË KONVENTËS PËR NDALIMIN E AKTEVE TË
PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË LUNDRIMIT DETAR, ADERUAR ME LIGJIN
NR.8850/2001, DHE PROTOKOLLIN 2005 TË PROTOKOLLIT PËR NDALIMIN E
AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË PLATFORMAVE FIKSE NË
SHELFIN KONTINENTAL, ADERUAR ME LIGJIN NR.8850/2001”**

- HYRJJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 15 tetor 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin 2005 të Konventës për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar, aderuar me ligjin nr.8850/2001, dhe protokollin 2005 të protokollit për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse në shelfin kontinental, aderuar me ligjin nr.8850/2001”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Brendshme.

- **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- **QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT**

Nëpërmjet këtij projektligji synohet aderimi i Republikës së Shqipërisë në Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Lundrimit Detar dhe Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave Fikse. Aderimi në këto protokolle të konventave kryhet në kuadër të përmbushjes të luftës kundër krimit në tërësi, goditjes së trafikimit, akteve terroriste, të cilat synojnë të realizohen në rrugë detare.

Aderimi në protokolle është iniciuar mbi bazën dhe nën frymën e respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në pajtim me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-**Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATOR

Edmond LEKA

KRYETARI

Ulsi MANJA